



05/ Nr/ 5850 / 2023

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nenit 5 shkronja b), në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHTI, Drejtoria e Arsimit, Hani i Elezit shpallë;

## KONKURS

**Për Regjistrimin e Nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Shkollën e Mesme të Lartë "DARDANIA" për vitin shkollor 2023/24**

Nr.	Emri i shkollës	Numri i paraleleve	Nr.i nxënësve	Profili (drejtimi)	Gjithsejtë
1	SHML "Dardania" Hani i Elezit	2	25	Shoqëror-Gjuhësor	50
		2	25	Shkencat Natyrore	50

### 1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazëve edhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2023/24, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë territorit të Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

### 2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të, në shkollën e mesme të lartë duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron),
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9), dhe
- Certifikatën e lindjes.

### **3.Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve**

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2023/24, bëhet nga data **18,19 e deri më datën 20 Korrik2023** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet, duke filluar nga ora **08:00-16.00**.

-Publikimi i rezultateve për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **21 Korrik 2023**.

**Shpallja e konkursit plotësues në muajin Gusht për vendet e lira me date 22.08.2023**

**Dorëzimi I dokumentacioneve per konkurs plotësues më date 22,23 dhe 24 Gusht 2023**

**Shpallja e rezultateve për konkursin plotësues me 25.08.2023**

-Kthimi i dokumenteve- tërheqja e dokumenteve, për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës **24 e deri më 31 Korrik 2023**.

### **4. Kriteret për regjistrim**

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- |                                       |             |       |        |
|---------------------------------------|-------------|-------|--------|
| -Nota mesatare e të gjitha lëndëve    | (klasa 6-9) | (60%) | 60pikë |
| - Nota mesatare nga lëndët prioritare | (klasa6-9)  | (40%) | 40pikë |

- **Kriteri i lëndëve prioritare nga sukcesi për shkollë te mesme të lartë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 e më lartë (Së pari gjendet mesatarja e 4 lëndëve prioritare veq e veq, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).**Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë **100** pikë.

### **5 Lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:**

#### **5.1 Gjimnazi i shkencave natyrore;**

- Lënda I-Fizikë
- Lënda II-Kimi
- Lënda III-Biologji
- Lënda IV-Matematikë

#### **5.2 Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore.**

- Lënda I- Gjuhë amtare
- Lënda II-Gjuhë angleze
- Lënda III-Histori
- Lënda IV-Gjeografi

## **Kriteret e përgjithshme për llogaritjen e pikëve .**

5.3 Nxënësi nga sukcesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl.6-9) mund t'i fitoj maksimalisht 60 pikë. Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është: (mes.kl.6+mes.kl.7+mes.kl.8+mes.kl.9)x3=60 pikë maksimumi.

5.4. Nxënësi nga sukcesi në lëndët prioritare maksimalisht mund t'i fitoj 40 pikë, shuma e mesatares së 4 lëndëve shumëzohet me  
 $2 \cdot (\text{mes.lënda(I)} + \text{mes.lënda(II)} + \text{mes.lënda(III)} + \text{mes.lënda(IV)}) \cdot 2 = 40 \text{ pikë.}$

5.5. Në rast se nuk mundë të behet pranimi ngase kandidatët kanë pikë të barabarta do të merren parasysh edhe këto kriteret shtesë. Sukcesi në klasat 1-5 mblidhet nota mesatare e 5 viteve dhe pjestohet me 5 pikë.

- 5.6.1. Pjesëmarrja ne gara ndërkombëtare të diturisë.....5pikë.
- 5.6.2. Vendi i pare në gara shtetërore të diturisë.....5pikë.
- 5.6.3. Vendi i dytë në gara shtetërore të diturisë.....4pikë.
- 5.6.4. Vendi i tretë në gara shtetërore të diturisë.....3pikë.
- 5.6.5. Vendi i parë në gara komunale të diturisë.....3pikë.
- 5.6.6. Vendi i dytë në gara komunale të diturisë.....2pikë.
- 5.6.7. Vendi i tretë në gara komunale të diturisë.....1pikë.

**Shih. Vendimin e Republikës së Kosovës - Ministria e Arsimit e datës 14.07.2023 për kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të nxënëve në klasen e X-të, për vitin shkollor 2023/2024.**

## **6. Afati i ankesave**

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve nga koha e shpalljes së rezultateve, t'i paraqes ankesë fillimisht drejtorisë së shkollës, e pastaj nëse sërish është i pakënaqur me përgjigjen e shkollës, mund t'i drejtohet Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA), në Han të Elezit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa. DKA dhe MASHT nuk shqyrton asnjë ankesë nëse ajo paraprakisht nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës i shkollës (pa e përfunduar procedurën interne).

**Data: 18.07.2023**  
**Hani i Elezit**

**Drejtori i Arsimit**  
**Hisni Luri**

